



## Nënat e besimtarëve

### Description

#### Muhamed Gazali

Disa shkrimtarë ngrenë polemika të ashpra mbi parimin e poligamisë, duke u përpjekur ta kufizojnë apo parandalojnë atë që Islami e ka lejuar në lidhje me këtë çështje. Ndonjëherë ata thonë se Islami nuk ka dhënë një leje të qartë dhe herë të tjera thonë se në ruajtjen e zhvillimit të qytetërimit dhe të interesave të njerëzimit, burri duhet të ketë vetëm një grua.

Pa dyshim këto mendime u shfaqën në shoqëritë tona, si rezultat i faktorëve të ndryshëm të cilët kishin nevojë për analiza të detajuara, për t'u refuzuar krejtësisht. Tashmë prej shumë vitesh kundërshtarët e poligamisë janë përpjekur për të ndryshuar ligjin, duke ia përshtatur pikëpamjeve të tyre. Megjithatë, përpjekjet e tyre çaluan kur ngjallën zemërimin e ulama (dijetarëve) dhe atyre burimeve që merren me çështjet Islame. Në atë kohë shkrova një artikull rreth natyrës së poligamisë, të cilën mendoj se është me vend ta përsërisë edhe këtu, para se të merrem me temën që kemi përpara, pasi ekziston një lidhje e qartë midis të dyjave.

Jeta ka vendosur ligje kulturore dhe ekonomike, të cilat pashmangshmërisht vendosen mbi njerëzit, në e ditshin apo jo ata, apo qofshin ata injorantë ndaj tyre apo që dështojnë të përgatisin vetet e tyre. Mes këtyre çështjeve që ligjet shoqërore përcaktojnë është edhe marrëdhënia e një burri me shumë gra, ku injoranca e trilluar mund të konsiderohet si një përpjekje e kotë në realitetin kundërshtues.

Kjo ndodh pasi përqindja e burrave ndaj grave mund të jetë ose i barabartë ose në favour të njëres palë. Nëse ato janë të barabartë apo nëse gratë janë më pak, atëherë automatikisht poligamia do të zhduket dhe natyra do të vendosi shpërndarjen e drejtë sipas numrit, ku çdo dëshirë e burrit, dashur padashur i duhet të pranojë fatin e tij. Megjithatë nëse numri i grave është më i madh se i burrave, atëherë ne jemi të detyruar të hasim një prej këtyre tre situatave të mundshme:

1. Me detyrim disa gra duhet të heqin dorë apo të privohen prej patjes së një burri, deri në vdekje.
2. T'u lejojmë burrave të kenë dashnore dhe të ligjërojmë tradhëtinë bashkëshortore.

### 3. Të lejojmë poligaminë

Mendojmë se vetë gratë, para burrave do të kundërshtonin një jetë të privuar, po ashtu nuk do të pranonin një jetë mëkatore dhe me shkelje.

Atëherë i vetmi burim, i lënë i hapur për gruan është të ndaj burrin e saj më një grua tjetër, e cila duhet të jetë në mbrojtjen e tij të drejtë, pasi ajo dhe fëmijët e saj konsiderohen të tijët. Në këtë mënyrë nuk ekziston asnjë mënyrë për mos pranimin e parimit të poligamisë që Islami pranon.

Për më tepër, ekziston një dallim i madh në dëshirat seksuale të burrave. Disa burra u është dhënë shëndet i mirë, instikt i gjallë dhe jetë e rehatshme, e cila nuk u është dhënë të tjerëve. Është anormale të barazojmë një burri me ndjenja të ftohta me një tjetër që posedon të kundërtën. A nuk u lejojmë sasi më të madhe ushqimi, atyre që kanë oreks të madh, gjë të cilën nuk ia lejojmë të varfërve dhe të dobtëve?

Ekziston edhe një arsye tjetër: gruaja mund të jetë e dobët fizikisht, e sëmurë, sterile apo e vjetër dhe përse duhet të flaket për këto arsye? Duke u bazuar në lidhjen e vjetër është e drejtë që ajo të qëndrojë nën mbrojtjen e burrit dhe që atij t'i jepet e drejta e zgjedhjes së një gruaje tjetër, i cili do të mbaj drejtësi të plotë në lidhjen martesore.

Pavarësisht justifikimeve për poligami, Islami rreptësisht refuzoi ta bënte atë përhapje të epsheve apo prirjeve të burrave kah kënaqësia dhe fuqia e tepruar. Taksat shkojnë në përputhje me pasuritë dhe ndërsa sigurohen letësira, ato ndiqen prej detyrave më të rënda. Në këtë mënyrë, në rastin e poligamisë, dikush duhet të sigurohet se mbizotëron drejtësia absolute. Nëqoftëse një burrë ka për qëllim lëndim e vetes, fëmijëve apo grave në poligami, atëherë poligamia nuk është e lejuar për të.

Nëse ligji konsideron pamundësinë për sigurimin e shpenzimeve të nevojshme si pengesë për t'u martuar, atëherë për më shumë arsye kjo konsiderohet pengesë për t'u martuar më shumë se një herë. Sheriati i këshillon të rinjtë që nuk kanë mundësi të martohen të agjërojnë dhe e urdhëron burrin që nuk ka mundësi të gjej grua, të qëndroj i pastër. E ata që nuk kanë mundësi martese, le të përmbahen derisa All-llahu t'i begatojë me të mirat e veta. (Kur'an 24:33)

Atëherë cila është pozita e dikujt që është i martuar me një grua? Atij i duhet të ushtroj më shumë vetëpërmbytje dhe pastërti.

Është e zakonshme që me gratë të vijnë shumë fëmijë dhe Islami e bën të detyrueshme përkujdesjen me drejtësi mes fëmijëve, në lidhje me arsimimin, trajtimin me dashuri dhe sigurimin e jetesës, nuk ka rëndësi nëse nënat e tyre ndodh që të jenë të ndryshme. Hadithi thotë: "Allahu e mallkon atë person që e bën fëmijën e tij kokëfortë apo të pabindur. Pasi babai poligamik duhet të jetë i vetëdijshëm për pasojat që sjell mosbarazia e ndjenjës së dashurisë apo dhembshurisë.

Po ashtu Islami e bën të detyrueshme drejtësinë midis grave. Megjithëse askush nuk mund të jetë i aftë për të kontrolluar prirjen e zemrës së dikujt, ende gjenden veprime dhe rrethana të tjera në të cilën burri mund të qëndrojë brenda kufijve të sheriatit, duke mbajtur drejtësi dhe patur frikë Allahun në lidhje me njerëzit dhe pasurinë që Ai ka vendosur nën kujdesin e tij.

Profeti a.s ka thënë: "Në të vërtetë Allahu do të pyesi secilin njeri rreth asaj që Ai i ka lënë nën kujdes,

në qoftë se e ka ruajtur apo e ka shkatërruar atë. Ai gjithashtu ka thënë: “Eshtë gjynah i mjaftueshëm për një njeri dëmi që mund ti shkaktojë atyre që i ka në zotërim”

Këto janë kufijtë e drejtësisë të cilën Allahu ka vendosur mbi poligaminë dhe çdokush që mund të barti ngarkesa të tilla mund të martohet dy, tre apo katër gra, nëse ai e dëshiron këtë, në të kundërt lejoni atë të jetë i kënaqur vetëm me një. “Dhe nëse i frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë, atëherë kënaquni me një”

Kam lexuar se disa gazetarë i kundërshtojnë parimet e poligamisë, ngase kërkojnë të dinë se përse burrave u lejohej të kenë më shumë se një grua, ndërsa grave nuk u lejohej të kenë më shumë se një burrë? I kam parë të gjithë këta njerëz dhe kam zbuluar se shumica prej tyre janë ose të pamoralshëm, të shturur ose rufjanë. U habita ngase ato jetonin në një botë të mëkatshme dhe ajo që urrenin më shumë ishte që familjet duhet të ngriheshin mbi themelet e pastërtisë.

Përgjigja për këtë pyetje të sëmure është se qëllimi i parë i marrëdhënies seksuale është krijimi i familjes dhe edukimi i fëmijëve në një atmosferë të pastër. Kjo nuk është e mundur në shtëpinë e një gruaje e cila frekuentohet nga një numër burrash dhe e cila nuk e di se cili është babai i fëmijëve të saj. Për më tepër roli i gruas në sferën e marrëdhënies seksuale është i marrësit, jo i dhënësit, i të udhëhequrit, jo i udhëheqësit. Gjithkush mund të mendojmë një motor që tërheq katër vagona, por jo një vagon që tërheq katër motora. Eshtë përgënjeshtër i natyrës së gjërave, për të debatuar se burrat nuk janë përgjegjës për gratë.

Me të vërtetë është e trishtueshme sesi shumica ka zgjedhur mos t’i marri parasysh këto kufij, duke shkuar në poligami pa qenë aspak i vetëdijshëm për kuptimin dhe zbatueshmërinë e drejtësisë së përshkruar. Në fakt, ata i janë përgjigjur thirrjes së epshit edhe pse i ka çuar ata drejt dhunimeve të përsëritura dhe padrejtësisë së qartë. Për shembull, një burrë i paaftë për të mbajtur veten, ende lufton për t’u martuar, si edhe një tjetër i paaftë për të mbajtur një, ende shikon për një të dytë. Dikush dështon në përmbushjen e nevojave të fëmijëve për arsimim, apo në shpërndarjen e pasurisë sipas kapriçove të tij, ndërsa akoma një tjetër martohet me një grua të dytë duke e braktisur të parën. Duhet parë nëse burri është i aftë për mbajtjen e katër grave si edhe të fëmijëve të tyre, apo ende jeton në varfërinë seksuale dhe shijon kompaninë e grave të pandershme. Cili është mjekimi i kësaj rrëmuje? A e mbron poligamia e jashtëligjshme Ummetin prej këtyre sëmundjeve? Sigurisht jo. Për të kufizuar të lejueshmen është provë e mungesës së të kuptuarit të ligjit Islam.

Megjithatë nëse Islami qëndron në heshtje mbi çështjen e poligamisë atëherë ka qenë detyra jonë për të dhënë opinionin tonë dhe në këtë rast ne duhet të jemi në favor të saj, në interes të mirëqënies publike, të cilën e kemi shpjeguar në fillim të diskutimit. Megjithatë, caktimi i rregullit është diçka, ndërsa keqzbatueshmëria e saj është një çështje tjetër. Kur legjislacioni duhet të zbatohet për të reformuar shoqërinë tonë dhe për të fuqizuar përkulshmërinë në lidhje me këtë, pastaj i lini ligjvënësit të kthejnë energjitë e tyre kah garantimi, se drejtësia është vendosur në gjithë aspektet e saj. Ndërkaq është humbje kohe dhe shfrytëzim i pavlerë debatimi mbi parimet e vetë poligamisë.

Konfidencialisht mund të them se kjo është një prej ndikimeve të kryqëzatës moderne kundra vendeve Islame, pasi Krishtërimi i vetmi nga gjithë fetë e tjera qysh prej kohës së Nuhut a.s e ka ndaluar poligaminë. I kufizonte të gjithë burrat vetëm me një grua, pavarësisht pozitës së tyre, duke e lënë shoqërinë të luftoj me problemet e tepërisë së grave dhe tërbimin e instikteve bazë me çdo lloj mjeti tjetër që mund të grumbullohej. Tashmë për shumë grupe poligamia konsiderohet si ves, ndërsa tradhëtia konsiderohet si argëtim i parëndësishëm. Problemi që tashmë ekziston është ai i besimit dhe

moralit në tërësinë e tyre dhe nën këto rrethana përpjekjet për të ndaluar poligaminë është një përpjekje e dallueshme për të njollësuar shoqërinë në kurriz të Islamit dhe në emër të ligjit.

Një numër i madh profetësh dhe njerëzish të drejtë janë martuar me një apo me më shumë gra, e cila nuk e pakësoi devocionin e tyre aspak. Faqet e Dhjatës së Vjetër, të cilat i kemi edhe sot janë dëshmi ndaj këtij fakti. Islami nuk e konsideron përmbajtjen nga marrëdhëniet seksuale si një formë adhurimi, ashtu si e konsiderojnë murgjit, si edhe nuk e konsideron mëkat martesën me katër gra, ashtu siç përshkruhet në Krishtërim. Mëkati lind, kur instikti seksual lihet të bredhi lirishëm apo ndrydhet në atë mënyrë sa gjen rrugëdalje të tjera, si ujërat e nëndheshëm.

Ajo çka transmetohet në biografite autentike të Profetit a.s. është se ai u martua me Hadixhen në moshën 25 vjeç ndërsa ajo ishte 40. Ai qëndroi i martuar me të dhe me asnjë tjetër, derisa zonja fisnike, e lartë ishte mbi 65 vjeç. Ajo vdiq kur ai ishte te të 50-at. Asnjë prej armiqëve të tij më të fortë nuk guxoi ta akuzonte për imoralitet apo paturpësi, dhe në këtë perudhë të jetës së tij, në kohën më aktive dhe më të mbingarkuar të çdo burri, ylli i ndershmërisë dhe fisnikërisë ndriçonte në ballin e tij kudo që ai shkonte.

Nëse ai do të kishte dëshiruar për t'u martuar me ndonjë tjetër, nuk ekzistonte as ligj as arsye apo zakon për ta ndaluar atë. Poligamia ishte traditë mes arabëve, e njohur si pjesë e besimit të babait të profetëve, Ibrahimit a.s. Megjithatë ai e kënaqi veten me një, në të cilën ai gjeti ngushëllim, lehtësim dhe rehati, pavarësisht se ajo ishte në moshë të vjetër kur ai ishte në kulmin e burrërisë. Ky qëndrim është me rëndësi të madhe.

Kur Hadixha ndërroi jetë, profeti deshi të rimartohej, ku bukuria nuk ishte prej kritereve të tij në zgjedhjen e patnereve të jetës. Edhe po të kishte vepruar në këtë mënyrë, ai nuk do të ishte kritikuar. Konsiderata kryesore e tij ishte fuqizimi i lidhjeve të tij me burrat, të cilët i kishin dedikuar jetët e tyre mesazhit dhe thirrjes së tij. Ai zgjodhi Aishen, vajzën e Ebu Bekrit, pavarësisht moshës së saj të vogël, zgjodhi Hafsën, vajzën e Umerit, pavarësisht mungesës së bukursë. Pastaj zgjodhi Ummu Selemen, vejushën e komandantit të tij, i cili ra dëshmor në rrugën e Allahut dhe bashkë më të gruaja e tij vuajti mjaft në migrimin në Abisini, dhe pastaj nga Abisinia në Medine. Përpara asaj ishte Saudah, një grua e cila kishte hequr dorë nga martesja për shkak të moshës së madhe. Jeta me këto katër gra nuk pritej të ishte e mbushur me zbatimje dhe gëzim edhe nëse ishte, nuk ka pse të fajsojmë Profetin a.s. për këtë. ?do besimtar ka të drejtën e tij për të shijuar shoqërinë e grave të tij, dhe nuk ka dyshim që Profeti a.s. i ka trajtuar që të gjitha me barazi.

Mund të thoni: Por Profeti a.s. kur ndërroi jetë la nëntë gra. Si ka mundësi kjo, po ashtu si mundet të ketë atë që të tjerët nuk munden? A mos është kjo hapje e derës drejt epshit dhe përgjigjes ndaj thirrjes së kënaqësisë? Në përgjigje të kësaj ne themi: A gjendet ndonjë vend për kënaqësi në jetën e një burri, i cili nuk qëndroi asnjë ditë të vetme larg përpjekjes së luftës së vazhdueshme dhe xhihadit rraskapitës? Me siguri shumë personalitete të rëndësisë së madhe janë kaq të zenë me problemet e njerëzve që mezi të shijojnë një orë pushim veçse kur duan të rifitojnë përfundimin mundimeve të pafund një herë e mirë. Atëherë si ka qenë situata e profetëve të mëdhenj, të cilët u përballën me perceptimin e arabëve siç edhe u treguam?

Po ashtu themi: ?farë vendi zë kënaqësia në jetën e një njeriu, i cili e kundërshtoi atë që në rininë e tij? A ka mundësi ta zhyste veten e vet brenda saj, kur ishte burrë i moshuar? Me siguri kushtet që i rrethonin pesë gratë e tjera e bënë të jetonte me to një pjesë të barrës që Profeti i duhej të barte në fuksionin e tij si udhëheqës shteti, ku ishte përgjegjës për komunitetin dhe çdo individ të tij. Po ashtu

ishite pjesë e përgjegjesisë së tij për të ngritur të mirën dhe për të çrrënjësuar të keqen.

Merr për shembull martesën e tij me Zejneb bint Jahsh: kjo martesë ishte një provim i vështirë për Profetin a.s. Allahu e kishte urdhëruar të hynte në të për të shkatërruar një traditë e cila ishte mjaft e përhapur mes arabëve, ku priu tërë siklet dhe vështirësi. Zejneb ishte njëra prej kushërirave të tij, të cilën ai e kishte njohur qysh në fëmijëri. Ishte ai që deshë ta martonte me Zejd ibn Harithah. Megjithëse, asaj nuk i pëlqeu ideja, dhe vëllai i saj e kishte kundërshtuar martesën për shkak të krenarisë të pozitës së familjes së tij. Zejneb ishte prej kurejshëve, ndërsa Zejd ishte një skllav të cilin Profeti a.s e kishte liruar dhe e kishte adoptuar si djalë dhe e thërrisnin Zejd ibn Muhammed. Profeti a.s. kishte insistuar në këtë martesë sepse ai donte të thyente krenarinë e arabëve në prejardhjet e tyre, ajo nuk kishte asnjë zgjedhje veçse të pranonte vendimin e Profetit a.s. mbi çështjen, veçanërisht pasi u shpall ajeti i mëposhtëm.

“Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës.” (Kur’an 33:36)

Kështu ajo u martua me Zejdin, pavarësisht ngurrimit në zemrën e saj. Shumë shpejt ai zbuloi se nuk mund të jetonte me atë dhe shkoi e u ankua tek Profeti a.s., i cili ndërhynte herë pas here për t’i vendosur gjërat në rregull, por pa rezultat. Në këto rethana Allahu i shpall Profetit a.s. se ai duhet ta lejoj Zejdin të divorcohet prej saj dhe se ai duhet të martohet me të. Profeti a.s ishte në shqetësim të madh me këtë urdhër të çuditshëm dhe ai e mbajti brenda vete, prej frikës se mos njerëzit do të thoshin se ai po martohet me nusen e djalit të tij, e cila nuk ishte e lejueshme. Megjithatë, çka njerëzit do të thoshin ishte ajo që Allahu donte të shkatërronte; ishte e detyrueshme për Profetin a.s të zbatonte këtë urdhër dhe duke shpresuar që Allahu do ta shpëtonte prej kësaj shtate. Madje ai shkoi më larg se kaq: kur Zejdi erdhi për t’u ankuar për gruan dhe i shpjegoi se ai kishte për qëllim të divorcohej me të, Profeti a.s i ka thënë: “Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga All-llahu!”, (Kur’an 33:37)

Pas kësaj zbriti shpallja që e qortonte Profetin a.s. për hezitimin e tij, duke e detyruar atë të zbatonte dëshirën e Zejdit që të ndahej prej gruas, dhe duke e detyruar atë të martohet me atë, edhe nëse njerëzit do të ngrinin zërat, duke thënë se ai u martua me nusen e djalit të divorcuar. Kjo ndodhi pasi adoptimi ishte një formë mashtruese, të cilën arabët e kishin traditë dhe për të cilën ata u detyruan ta braktisin. Leje veprën e Profetit a.s. për të dhe ata afër tij të jenë të parët që do ta shkatërrojnë xhahilijen e kësaj tradite mjaft të përhapur.

Kjo është historia siç fillon të na e rrëfej Allahu:

“(Përkujto) Kur i the atij që All-llahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: “Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga All-llahu!”, e ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që All-llahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t’i frikësohesh All-llahut. E pasi që Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzuar ty atë, e për të mos pasur besimtarët vështirësi (mëkat) në martesë me gratë e të adoptuarve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i All-llahut është kryer.” (Kur’an 33:37)

Gjë e çuditshme në këtë histori është ajo çka mendjelehtët trilluan një dramë dashurie të pavlerë me intriga plot epsh. Ata pretendojnë se Profeti a.s ra në dashuri me Zejnebin dhe i mbajti të fshehura ndjenjat. Megjithatë kjo doli në dritë dhe ai u martua me të pasi ajo u divorcua. Po ashtu ata pretendojnë se pjesa e parë e ajetit të cituar më sipër erdhi si qortim për ndjenjën e tij të ndrydhur.

Jemi mjaft të habitur nga ky absurditet i llahtarshëm dhe i përpjekjes për të fshehur të vërtetën me pavërtetësi. Kush mund ta kishte ndaluar Muhammedin a.s. prej martesës me Zejnebin nëse ai e dëshironte? Ajo ishte kushurira e tij dhe ishte ai i cili i dha asaj për martesë një burrë të cilin ajo nuk e donte. Profeti a.s. insitoi vetë në këtë martesë dhe bëri më të mirën për ta bindur atë. A do të kishte ai ndonjë synim për të, pasi t'ia kishte dhënë dikujt tjetër?

Tani le të shohim në ajetin për të cilin ata pretendojnë se përfshin qortimin e Proffit a.s. Ata thonë se çështja të cilën ai e mbajti të fshehur brenda vetes dhe të cilën kishte frikë ta shfaqte tek njerëzit ishte dashuria e tij për Zejnebin. Me fjalë të tjera, Allahu e qortoi atë, siç ata pretendojnë, për mos shfaqjen e dashurisë së tij. A është prej standarteve morale që pasi një burrë dashuron një grua, të bredh duke reklamuar dashurinë e tij, veçanërisht kur ndodh që të jetë i llojit të prishur, ku ai do gruan e një tjetre? A do ta qortonte Allahu një burrë, pasi ai të donte gruan e një tjetri dhe duke e fshehur dashurinë në zemrën e tij? A do të ishte lartësuar pozita e tij nëse ai do të bënte poezi dashurie rreth saj? Këto janë gjepura, për atë Zot! Dhe janë këto gjepura me të cilat disa budallenj dëshirojnë të shpjegojnë Kur'anin.

Allahu nuk qorton askënd për fshehjen e dashurisë së pamend. Faktet e historisë janë siç i shpjegova. Ajo çka fshehu Profeti në zemrën e tij ishte frika e të kuptuarit e kësaj martese të obliguar, vonesa e tij në zbatimin e urdhrit të Allahut dhe frika e tij ndaj trazirës që do të bënin njerëzit kur të zbulonin se tradita e tyre e dashur e adoptimit do të shkatërrohej. Megjithatë, Allahu i shpjegoi Profetit të Tij se ai nuk duhet të lejoj asnjë imagjinatë kundërshimi për të ndaluar zbatimin e urdhrit të Tij, se ai si gjithë Profetët para tij, nuk kishte zgjedhje tjetër por të dëgjonte dhe të bindej.

Nëse i kthehemi ajetit i cili flet rreth dashurisë, mund ta gjeni duke përfunduar me këtë deklaratë: "Urdhri i Allahut duhet të përmbushtet". Pastaj u pasua nga dy ajetet, që theksojnë këtë të kuptuar:

"Pejgamberit nuk i përket kurrnjë qortim për atë që All-llahu e ngarkoi me të. Ky ishte ligj i All-llahut edhe ndër ata që ishin më parë, e urdhri i All-llahut është vendim i kryer. (ligj i All-llahut ndër) Ata, të cilët i kumtojnë shpalljet e All-llahut, i frikësohen vetëm All-llahut e askujt tjetër pos Tij, e All-llahu është i mjaftë të jetë llogaritës." (Kur'an 33:38-39)

Kur dëshiron t'i qetësosh njerëzit thuaju: "Kini frikë vetëm Allahut." Mos ua thuaj këtë kur janë duke kryer një krim. Thuaju vetëm kur ndërmarrin një vepër fisnike të virtytit të lartë, që bie ndesh me traditat e trashëguara. Është mjaft e qartë prej këtyre ajeteve, se Allahu nuk po e shtynte Profetin e Tij, për të rënë kokë e këmbë në dashuri me një grua, por duke e nxitur atë për t'i dhënë zemër në çrrenjosjen e një praktike të keqe e cila përkrahej fuqishëm, dhe se vetë ai i ishte nënshtruar asaj. Kjo është arsyeja përse menjëherë pas kësaj Allahu thotë:

"Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshtëm për çdo send." (Kur'an 33:40)

Për sa u përket zonjave të tjera me të cilat Profeti u martua, ato ishin nga familje fisnike dhe mund të konsideroheshin vajza të mbretërve. Shumë rrethana i kanë vënë në rrezik, kur atyre iu desh të pranonin Islamin, të cilat prijësi i thirrjes nuk mundi t'i mospërfillte.

Ummu Habiba ishte e bija e Ebu Sufjanit, prijisi i kurejshëve dhe udhëheqësi i saj në luftën e njëzetë me Islamin. Ajo e pranoi Islamin, duke e kundërshtuar hapur babain dhe fisin e saj për hir të Allahut. Ajo migroi nga Meka, ku sundonte babai i saj, për në Abisini. A mendoni se Profeti do ta kishte lënë këtë zonjë, pas vdekjes së burrit të saj, në peripecitë e kohës? Ai e morri atë për grua për nder të

vlerësimit të sakrificës së saj në rrugën e Allahut.

Safijah ishte e bija e Hujajit, mbretit hebre. Babai, vëllai dhe burri i saj vdiqën në konfliktin mes Islamit dhe Judaizmit, ku ajo ra për pjesë një ushtari i cili dinte vetëm se ajo ishte një robërshë lufte për t'u përdorur si ti shkonte atij për shtatë. Nëse Profeti a.s. u tregua i mëshirëshëm dhe i dha asaj lirinë, i lehtësoi plagët dhe e nderoi të kaluarën e saj duke u martuar me të, a mund të fajsohet ai për këtë?

Xhuvajrijah ishte e bija e Al Harithit, prijësi i Banu al Mustalikëve. Fisi i tij hasi disfatë nga duart e muslimanëve dhe që të gjithë u morrën si robër lufte. Profeti e ngushëlloi prijësin e hidhëruar duke u martuar me vajzën e tij, në këtë mënyrë ai u mësoi muslimanëve sesi të sillen me fisnikëri dhe zemërgjerësi. Ajo çka ai dëshironte prej kësaj ndodhi, domethënë rikthimin e lirisë në fis, të burrave dhe grave, pasi muslimanët u ndienë të shqetësuar që kishin si robër lufte krushqit e Profetit.

Mund të ndodh në mendjet e atyre që kanë pak njohuri rreth siras, se jeta e Profetit a.s. ishte e ngritur mbi tepri të ushqimit, pijeve dhe kënaqësi të tjera. Pamja që shfaqet menjëherë për ta është e një njeriu i cili kishte shumë gra, që do të thotë se ai ishte i zhytur në epshe materiale, ku tavolina e tij ishte e tejmbushur me gjithë llojet e mishërave, frutave dhe pijeve dehëse, ndërsa shijonte shoqërinë e grave joshëse dhe çdo ditë ndihej në një gjendje të shkujdesur. Kjo panoramë mund të jetë shumë apo pak e asaj çka ndodh në pallatet e mbretërve. Megjithatë, kini kujdes se mos bëheni budalla i vetes nga mendimi se një copëz e atij luksi mund të gjendej në shtëpitë e Profetit a.s. Ktheheni mendjen menjëherë në një lloj tjetër jete të thjeshtë për të parë në të një burrë, shqetësimi i të cilit ishte vetëm për të vërtetën, i cili luftoi për njohjen e saj dhe u përpoq në maksimum për të grumbulluar njerëzit rreth saj, kënaqësia e të cilit gjendet në hapat e tij, që e sollën afër qëllimit të tij dhe e larguan prej epsheve tokësore.

Nëse gjyket e topave mbi sipërfaqen e tokës do të arrin yjet më të largët, vetëm atëherë joshjet e kësaj jete do ti afroshin zemrës së Muhamedit a.s. Ky ishte njeriu i zgjedhur dhe i pastruar nga providenca hyjnore, dhe kështu qëndroi në pritje të botës tjetër. Ai ka thënë: “?farë duhet të bëj me këtë botë? Unë jam thjesht një njeri që qëndron nën hijen e pemës pastaj çohet dhe e len atë.” Aspiratat e tij ishin drejt idealeve të larta dhe ndaj asaj që do të jetë fati i çdokujt kur t'i kthehet Allahut: “Vendi ku bie një kamzhik në parajsë është më e mirë se gjithë bota dhe çka në të, ku një ecje e një mëngjesi apo një mbrëmje në rrugën e Allahut, është më e mirë se gjithë bota dhe çka në të.

Jeta e tij me gratë ishte një rrugicë e vështirë të cilën asnjëri nuk mund ta bart. Buhariu transmeton në autoritetin e Enesit Ibn Malik: “Nuk di që Profeti a.s të ketë parë copë buke të hollë para se të ndëronte jetë, as nuk ka parë ndonjëherë Sumeyt me sytë e tij.”

Aishja transmeton: “Ne shihnim tek hëna e re- tre hëna në dy muaj dhe asnjë zjarr(për ushqim) nuk ndizej në shtëpitë e Profetit a.s.”

‘Uruah ibn al Zubajr e pyeti atë: “Cfarë ju dha ai për të ngrënë?”

Ajo u përgjigj: “Dy gjëra të zeza: hurma dhe ujë.” A’ishja po ashtu transmeton: “I Dërguari i Allahut a.s. vdiq dhe në dollapin tim nuk kishte fare mish për të ngrënë. Në njërin prej rafteve gjendej vetëm një copë buke elbi.”

Krevati që përdorte për të fjetur, ishte bërë prej lëkurës me fibër.

Ai do të qetësohej në të, dhe pa e ngrohur mirë atë, më të kënduar një gjel, ai do të ngihet në përgatitjen e faljes së mëngjesit.

Nga ky përshkrim, nuk duam të themi se Islami i urren gjërat e mira të jetës apo se Profeti a.s. vendosi një shembull për njerëzit që ti braktisin ato. Sheriati është i thjeshtë dhe i qartë mbi këtë çështje. Ne po paraqesim faktet e jetës së një burri që nuk pati dëshira për gjëra që njerëzit e tjerë vrisnin vetet për to. Një burrë u jep fëmijëve të tij të vegjël një lodër, që të gëzojnë dhe ata luftojnë njëri-tjetrin për të, por natyra e tij burrërore e mban atë larg lojës së fëmijëve. Disa shkencëtarë dhe mendimtarë harrojnë ushqimin që është përgatitur për ta, jo si përbuzje e tij, por mendimet e tyre janë tërësisht të zhytur në shkencat e tyre. Mundem të shoh tek Profeti a.s. sesi e pa shumicën e njerëzve të luftojnë mbi kënaqësitë e rrufeshme, duke tundur kokën dhe duke u thënë: “Nëse e di atë që unë di, do të qeshni pak dhe do të qani shumë.” Pastaj do t’i lutej Allahut; “O Allah, siguroi familjes së Muhammedit ushqim” Është përbuzje për intelektin dhe padrejtësi zhurmëmadhe për historinë, që një i jashtëm duhet të shikoj apo të dëgjoj se Muhammedi kishte shumë gra, duke u bazuar mbi këtë të përfundojë se kjo është provë e privilegjit për kënaqësi dhe përmbushjes së epshit.

Në anën tjetër, askush nuk duhet të mendoj se kjo jetë e thjeshtë ishte sepse ai nuk kishte mundësi të jetonte më mirë, se nëqoftëse Muhammedi do të kishte patur mundësi për një jetesë plot luks, ai do ta kishte shijuar veten dhe do të kishte grumbulluar pasuri dhe grave të tij do t’u ishin plotësuar kërkesat dhe do të kishin grumbulluar pasuri në mënyra të ndryshme. Jo. Ai e kishte forcën për të mbajtur për vete pasuri, e cila kalonte si fillim prej duarve të tij dhe nën kontrollin e tij. Megjithatë, shpirtmadhi Muhammed qëndronte mbi dëshirën e kënaqësive të vogla pasi sytë e tij ishin të fiksuar në një qëllim më të lartë. Nëse atij i ishte siguruar thesari i tërë botës, mendimi i tij i parë do të ishte të kënaqte nevojën e njerëzve përpara çdo gjëje tjetër.

Ebu Hurejra ka thënë:

“Po ecja me Profetin a.s. në fushën e llavës afër Medinës. U drejtuam nga Uhudi dhe ai tha: “Ebu Dharr”

Unë iu përgjigja dhe ai vazhdoi “Nuk do të kisha dashur të kisha flori sa mali i Uhudit dhe pas tre ditësh të kisha ende një dinar prej pasurisë time përveç një borxhi të vogël për të shlyer.” Duhet t’ia fal robërve të Allahut si filanit dhe filanit.” Ai tregoi kah të djathtës dhe të majtës së tij si edhe mbrapa tij. Ai eci për pak dhe pastaj tha: “Ata me më shumë do të jenë prej të paktëve në Ditën e Gjykimit përveç atyre që bëjnë këtë dhe këtë, ai tregoi në të djathtën, në të majtën dhe mbrapa tij, dhe me të vërtetë ata janë pak.”

Ushqimi më i shijshëm në gojën e një njeriu të ngopur nuk jep asnjë kënaqësi. Profeti ishte i ngopur në zemër dhe shkëlqimi i botës ndaj të cilës të tjerët do të nguteshin nuk do të lëvizte asnjë fije floku prej kokës së tij. Nuk është habi, që ai e shpërndante për të nevojshëmit dhe shpresuesit çfarëdo që i arrinte, pasi pasurinë ai e kishte në zemër. Për këtë qëndrim flet Allahu në Kur’an:



“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë), e për t’i sprovuar me të, sepse shpërbimi i Zotit tënd është më i mirë dhe është i përjetshëm. Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet. (Kur’an 20: 131-132)

Ajo që Profeti a.s dëshironte më shumë ishte të mbrohej prej peripecive të botës dhe padrejtësisë së njeriut, dhe që ai dhe familja e tij mos të poshtërohej nga varfëria. Ai jetoi me parimin: “Çka është e pakët dhe e mjaftueshme është më e mirë se çka është e shumtë dhe munduese.” Brenda kufijve të së paktës dhe të mjaftueshmes ai donte të ishte i lirë prej kthetrave të njerëzve, kështu që ai i lutej Allahut: “O Allah, kërkoj strehim tek Ty prej varfërisë, urisë dhe turpit, prej bërjes keq (ndaj të tjerëve) apo prej të qenurit i bërë keq dhe prej sjelljes padituri apo që të tjerët të sillen padituri ndaj meje.” Ai ka thënë: “O Allah, kërkoj nga Ty udhëzim, devocion, shëndet dhe vetmjaftueshmëri.” Kjo formë e ashpër jetese i detyroi gratë e tij të duronin vështirësitë që nuk i kishin njohur më parë. Shumica e tyre vinin prej shtëpive luksoze dhe ishin mësuar në kohën më përpara të jetëve të tyre me ushqime të mira dhe bollëk, si nga baballarët apo nga burrat e tyre të mëparshëm. Si rrjedhim nuk ishte aspak habi, që ato të shqetësoheshin për këtë jetë të re dhe të kërkonin qetësi, lehtësim dhe rehati. Ato u mblodhën së bashku, pavarësisht dallimeve të vogla që ato kishin, për t’i kërkuar Profetit a.s. rritje të kuotës financiare. Ata ishin në shtëpinë e njeriut më të lartë mes arabëve, dhe si rrjedhim mënyra e jetesës duhet të ishte me vlerë nominale me pozitën e tyre. Rolin udhëheqës të këtyre kërkesave e morrën Aishja dhe Hafsa, ndërsa të tjerat i shoqëronin ato.

Profeti u mërzi shumë nga ky manifestim. Ai ishte i pari musliman në sipërfaqen e tokës, ku gjithë sytë e besimtarëve, burra dhe gra, ishin përqëndruar mbi atë, nga çdo drejtimi pasi ai ishte në rrjedhën e ndërtimit të një kombi, për të cilin duhej luftuar në rrugën e tij përmes hordhive armike të vendosura në pritje. Nëse familja e tij nuk jetonte jetën e një luftëtari, i cili ishte i rrethuar, atëherë si mundte ai të mbante luftën dhe t’i autorizonte apo t’i ngarkonte burrat dhe gratë e Ummetit për të hequr dorë nga çdogjë, me qëllim vazhdimin me këtë fe deri sa të arrinte pikën e sigurisë? Për këtë arsye, Profeti a.s. refuzoi t’u përgjigjej kërkesave të grave të tyre për rritje të kuotës financiare. Në mosmiratimin e një kërkesë të tillë, ai vendosi ti bojkotonte ato, dhe u përhapën fjalë se Profeti a.s. i kishte ndarë gratë e tij.

Ebu Bekri dhe Umeri u alarmuan nga këto fjalë, pasi ata ishin baballarët e nuseve të Profetit. Ata shkuan dhe kërkuar një pjesëmarrje me atë për të verifikuar faktet. Me të hyrë ata e gjetën atë të heshtur dhe gratë e tij të brengosura rreth tij. Umeri e pyeti nëse ishte e vërtetë që ai ishte ndarë prej grave të tij dhe ai i tha jo.

Pavarësisht atmosferës së vakët që vazhdonte rëndshëm në shtëpi, Umari vendosi të fliste me Profetin a.s. dhe ta bënte atë të qeshte. Ai i ka thënë: “O i Dërguar i Allahut, po të kishe parë të bijën e Zejdit (gruan e tij) kur më kërkoi pak më përpara për një rritje të kuotës financiare dhe unë ia këputa kokën.”

Profeti a.s. qeshi aq sa iu dukën dhëmbët dhe pastaj ka shtuar: “Ato më kërkuar një rritje të kuotës financiare.”

Pas kësaj Ebu Bekri shkoi tek Aishja dhe e qortoi atë, po ashtu edhe Umari shkoi tek vajza e tij Hafsa. Që të dy u thanë: “A i kërkuar Profetit a.s. atë çka ai nuk e ka?”

Profeti a.s. i paralajmëroi të dy baballarët të mos u bënin asgjë bijave të tyre. Gratë e tij janë penduar.

Ato thanë: “Për Zotin, ne nuk do ti kërkojmë të Dërguarit të Allahut a.s. pas këtij tubimi, atë që ai nuk e ka.”

Megjithatë Profeti a.s. qëndroi larg tyre për një muaj deri sa ato u penduan. Pastaj Allahu shpalli ajetet e sures Ahzab, e cila u kërkoi atyre ose të kërkonin botën tjetër me Profet a.s. mënyra e jetesës së tij ishte e këtillë, ose të ktheheshin tek familjet e tyre ku do të gjenin veshje të fisme dhe ushqim të shijshëm.

Ky mësim ishte i mjaftueshëm për të fshirë nga mendjet e tyre hapat e tyre të dëshirës, e cila u desh të kapërcente fazat e diskutimit të zjarrtë. Ato të gjitha zgodhën të qëndronin me Profetin a.s. sipas parimit të tij të vjetër “çka është e pakët dhe e mjaftueshme është më e mirë se ajo çka është me bollëk dhe munduese.” Pas kësaj ato jetuan me atë në rrugën e Xhihadit dhe Tahaxhudit, sakrificës dhe dashamirësisë, thjeshtësisë dhe shërbimit.

“O ti Pejgamber, thuaju grave tuaja: “Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stilit të saj, atëherë ejani: unë po ju jap furnizimin (për lëshim) dhe po ju lëshoj ashtu si është e rrugës. E në qoftë se e doni All-llahun, të dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se All-llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira.” (Kur’an 33:28-29) Ato zgjedhën Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe strehimin e botës tjetër, ato jetuan me Profetin si ndihmëse të së vërtetës dhe të shpërblimit të dëshiruar. Me këtë vetëmohim në shërbim të profetësisë dhe shpërfilljes apo mos marrjes parasysh të dëshirave egoiste, Allahu ua lartësoi pozitën dhe ato u bënë jo thjesht gratë e një burri që kërkonte kënaqësi por partnere për një jetë të çmuar, të virtytshme, dhe ato fituan titullin që Allahu u dhuroi atyre kur u tha:

“Pejgamberi është më i ndieshëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetë vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre. E ata (të afërmit) farefisi nga barku, sipas dispozitave të All-llahut, kanë më tepër përparësi ndaj njëri-tjetrit se sa besimtarët e tjerë dhe se sa muhaxhirët (të mërguarit), përveç nëse dashamirëve tuaj doni t’u bëni ndonjë të mirë (u lini testament ose diç tjetër). Kjo është e regjistruar në librin e shquar (Levhi Mahfudh, Kur’an).” ( Kur’an 33:6)

Për të theksuar këtë amësi shpirtërore, nënave të besimtarëve iu kërkua të veshin hixhab të plotë dhe nuk i lejohej asnjë të huaji t’i takonte ato edhe i shoqëruar nga një mahram. Cdo pyetje e bërë për to rreth çështjeve të Islamit apo çështje të kësaj bote duhet të bëheshin pas një perdeje dhe ishte e ndaluar për ndokënd të marotohej me to pas vdekjes së Profeti a.s. Ky ligj vendimtar vendosi një ndalesë ndaj atyre njerëzve kureshtarë dhe të papëlqyeshëm, që frekuentonin shtëpitë e udhëhëqësve, vetëm për të vendosur një ndalesë ndaj atyre që shpresonin për lavdi duke u martuar më këto zonja. Nuk shohim asgjë të çuditshme në këtë ligj, pasi disa burra ishin kaq të guximshëm, sa njëri prej tyre tha se : “Kur profeti a.s. të ketë vdekur, unë do të martohem me Aishen!” Ishte e drejta e Profetit që ndjenja e tij të mbrohej, ku ai dhe familja e tij të ishte e ruajtur prej beduinëve të tillë të trashë.

Profeti a.s. nuk pati asnjë djalë nga gratë e tij. Vajzat që pati nga Hadixhja të gjitha i vdiqën që kur ai ishte gjallë, me përjashtim të Fatimes. Ajo jetoi pak muaj pas vdekjes së tij dhe ishte e para e familjes së tij që e ndoqi në varr. Ai pati një djalë me Marian, të cilën ia solli si dhuratë Patriarku i Aleksandrisë dhe ajo pranoi Islamit. Ai e quajti djalin Ibrahim, pas stërgjyshit të tij, babai i Profetëve. Megjithatë, ai nuk jetoi gjatë dhe vdiq në fëmijëri.

Enesi ka thënë: “E pashë atë duke dhënë shpirt përpara Profetit a.s. Sytë e Profetit a.s. u lagën nga

lotët dhe ai tha: “Sytë qajnë dhe zemra ndihet e hidhëruar, por gojët tona nuk thonë asgjë përveç asaj që e kënaq Zotin tonë, dhe ne jemi të hidhëruar për ty o Ibrahim.”

Në të njëjtën ditë ndodhi një eklips diellor, dhe njerëzit thanë se ishte për shkak të vdekjes së djalit të Profetit a.s. Për këtë Profeti a.s. qëndroi në mes të njerëzve dhe u tha: “O njerëz, dielli dhe hëna janë shenja të Allahut dhe ata nuk errësohen me vdekjen e ndonjë njeriu. Saherë të shihni që ndodh eklipsi, kryeni falje derisa eklipsi të ketë mbaruar.

**Date Created**

16/10/2014

**Author**

erasmusi